

## Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Thessaly, Greqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për traineeship për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Thessaly, Greqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

<https://www.uth.gr/en>

<https://www.uth.gr/en/international/erasmus/international-credit-mobility>

### Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për traineeship;

### Kohëzgjatja e bursave:

- 2 deri në 4 muaj;

### Fushat:

- Kimi ushqimore;
- Sistemi i informacionit gjeografik të aplikuar;

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Bachelor / Master:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze) (për studentët e nivelit master – listë notash e nivelit bachelor dhe nivelit master);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës angleze);
- Dokumenti i gjuhës së huaj, sipas linkut:

[http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/english\\_language\\_requirement.pdf](http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/english_language_requirement.pdf)

- Application form, sipas linkut:

<http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/StudentApplicationForm.docx>

- Student Information sheet, sipas linkut:

<http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/DataStudentInformation.docx>

- Data of incoming students:

[http://erasmus.uth.gr/docs/English/Studies/Data\\_of\\_incoming\\_students.doc](http://erasmus.uth.gr/docs/English/Studies/Data_of_incoming_students.doc)

- Dokumenti Learning Agreement\* for traineeship;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[http://erasmus.uth.gr/docs/V\\_ii-Erasmus\\_107\\_2020\\_copy\\_copy\\_copy.docx](http://erasmus.uth.gr/docs/V_ii-Erasmus_107_2020_copy_copy_copy.docx) \

Udhëzuesi për plotësimin:

[http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/DOCUMENTS/HE\\_-\\_Guidelines\\_-\\_Learning\\_agreement\\_for\\_traineeships\\_2022\\_KA171.docx](http://erasmus.uth.gr/docs/ICM/DOCUMENTS/HE_-_Guidelines_-_Learning_agreement_for_traineeships_2022_KA171.docx)

Afati për aplikim: **27 Shkurt 2023**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!